

KONTRATË SHITJE KUOTE

Sot më datën 16.10.2023 palet e meposhteme hartuan dhe nenshkruan kete kontrate si me poshte vijon:

SHITESI: **Z. Ilir Shtufi**, i biri i Xhemal-it, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, i datelindjes 13.10.1973, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Karte identiteti Nr.H31013090C. (referuar ketu dhe ne vijim si "**Shitesi**").

dhe

BLERESI: **Z. Kujtim Shtufi**, i biri i Xhemal-it, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, i datelindjes 01.02.1966, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Karte identiteti Nr.G60201155M. (referuar ketu dhe ne vijim si "**Bleresi**").

MEQENESE EKZISTOJNE KUSHTET PARAPRAKE:

- Shitesi, Z. Ilir Shtufi eshte Ortak ne Shoqerine "LTD Co" Shpk, rregjistruar ne rregjistrin tregtar me Nr.NUIS-i L42117004B ,njeherazi zoterues i nje kuote qe perben 10 % pjesemarrje ne kapitalin e Shoqerise .
- Z. Kujtim Shtufi deshiron te bleje nga Z. Ilir Shtufi kuoten qe perben 10 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise "LTD Co" Shpk.
- Ne baze te Vendimit Nr.12, date 16.10.2023 te Mbledhjes se asamblese te Ortakeve te Shoqerise "LTD Co" Shpk, shitesi Z. Ilir Shtufi, duke qene Ortak i Shoqerise dhe njeherazi zoterues i nje kuote qe perben 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise, i shet Z. Kujtim Shtufi kuoten e tij
- Bleresi eshte dakort dhe pranon blerjen e kuotes te mesiperme nga shitesi Ilir Shtufi, duke pranuar dhe kushtet e likujdimit sipas percaktimeve te kesaj kontrate.

PER SA ME SIPER, si dhe duke marre parasysh marreveshjet reciproke te permbajtura ne kete akt, palet bien dakord si me poshte vijon:

NENI 1

BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE

Sipas dispozitave te kesaj Kontrate, **Shitesi** nepermjet ketij akti i shet **Bleresit dhe ky i fundit** blen 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 10 % pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise "LTD Co" Shpk me nr. NUIS L42117004B . Kjo kuote blihet me cmimin e percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate.

NENI 2

ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES

2.1. Çmimi i blerjes se kuotes objekt i kesaj Kontrate qe Shitesi ia shet Bleresit eshte ne vleren prej 31,000,000 Leke (tridhjetë e njemilion leke) , me poshte i quajtur "Çmimi i Blerjes", vlere e cila do te likujdohet nepermjet llogarise bankare nga Bleresi ne favor te Shitesit brenda gjashte muajve nga nenshkrimi i kesaj kontrate shitje.

2.2. Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per shoqerite tregtare", palet jane dakord qe:

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Bleresi ka detyrimin te paguaje cmimin e kuotes objekt kontrate sipas percaktimeve ne nenin 2.1.

Kjo kontrate me nenshkrimin do te depozitohet prane QKB-se me qellim qe te behet kalimi i pronesise se kuotes ne emer te Bleresit.

Ne rast se Bleresi nuk likujdon cmimin objekt kontrate brenda afatit te percaktuar ne kete akt, atehere Shitesi rifiton te gjitha te drejtat duke e zhveshur Bleresin nga cdo e drejte pronesie.

NENI 3

DEKLARATAT DHE GARANCITE

3.1. Shitesi deklaron dhe garanton se:



- (i) nenshkrimi dhe zbatimi e kesaj kontrate eshte autorizuar rregullisht
- (ii) kjo kuote qe transferohet eshte e lire nga çdo barre apo ndonje pretendim tjetër ligjor nga pale te treta,
- (iii) për shitjen e kuotes eshte mbajtur dhe mbledhja e asamblese se ortakeve ne te cilen Bleresi, njeherazi ortak me Shitesin ne shoqeri, ka shprehur interesin për te ushtruar te drejten e parablerjes se kuotes, kuote te cilen me ane te ketij akti e blen nga ortaku/Shitesi.

3.2. Bleresi deklaron dhe garanton se:

- (i) nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate eshte autorizuar rregullisht
- (ii) ka te drejten, dhe nuk ka ndonje ndalim ligjor apo te ndonje lloji tjetër, për te nenshkruar dhe zbatuar kete Kontrate dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj;
- (iii) Bleresi ka nenshkruar dhe do te shlyeje ne menyre te plote kuoten, objekt i kesaj Kontrate ne llogarine bankare te Shitesit sipas percaktimeve dhe dakordesise ne kete akt;

3.3 Kjo Kontrate nenshkruhet rregullisht sot ne date 16/10/2023 dhe eshte shprehje e vullnetit te lire dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem për Shitesin dhe Bleresin te cilet kane detyrimin qe menjehere ta depozitojne prane QKB-se me qellim reflektimin e te dhenave te pronesise mbi kuotat e shoqerise. Ne perfundim te transaksionit dhe me rregjistrimin e ketij akti jo noterial por te ligjshem dhe te vlefshem për palet, Bleresi Z.Kujtim Shtufi do te jete ortak dhe zoterues i nje kuote me 60 % pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise, Shitesi Ortaku Ilir Shtufi do te largohet nga shoqeria dhe Ortaku Luciano Koceku do te vazhdoje te zoteroje nje kuote me 40% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise "LTD " shpk..

NENI 4

TE NDRYSHME

Kjo Kontrate, nenshkruhet ne 4 (kater) kopje te barasvlefshme ne gjuhen shqipe me nga 2 (dy) faqe secila dhe perben marreveshjen e plote midis paleve.

NENI 5

LIGJI I ZBATUESHEM DHE MOSMARREVESHJET

5.1. Problemet ne lidhje me çeshtje qe mund te lindin sipas kesaj Kontrate por qe nuk jane parashikuar ne te, do te zgjidhen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, te cilet do te jene te zbatueshme ne kete Kontrate.

5.2. Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ketu ne lidhje me kete Kontrate dhe qe nuk do te zgjidhet nga negociatat midis tyre, do te jete objekt vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

5.3 Kjo kontrate shitje kuotash, perpilohet ne baze te Vendimit Nr.12, date 16/10/2023 te Mbledhjes se Asamblese, bashkengjitur kesaj kontrate.

Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje identike, ne gjuhen shqipe dhe palet e lexuan , e gjeten konform vullnetit te tyre dhe e nenshkruan.

PALET

BLERESI

Kujtim SHTUFI

SHITESI

Ilir SHTUFI

VENDIMI NR.12
I MBLEDHJES SE ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
“LTD CO” SHPK

Sot, më 16.10.2023, shoqëria “LTD Co” shpk, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me NUIS. L42117004B, therret mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve në seline e shoqërisë me adrese Rruga “Kajo Karafili”, mbrapa ish lidhjes se shkrintareve, Tiranë.

Mbledhja u thirr dhe u drejtua nga Administratori i shoqërisë.

Rendi i ditës:

Miratimi I shitjes se nje Kuote me 10% pjesemarrje, kuote e cila zoterohet nga ortaku Ilir Shtufi dhe miratimi I blerjes se kesaj kuote nga ortaku Kujtim Shtufi.

Prezent në mbledhje janë ortakët e shoqërisë:

Z. Ilir Shtufi zotërues i nje kuote me 10 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë.

Z. Kujtim Shtufi zotërues i nje kuote me 50 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë.

Mori dijeni rregullisht dhe nuk u paraqit ortaku:

Z. Luciano Koceku zotërues i nje kuote me 40 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë.


Administratori z. Enea Mitrushu do të mbajë procesverbalin e mbledhjes.

Pasi u diskutua gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja e Ortakëve vendosi:

- 1- Miratimin e shitjes se Kuotes me 10% pjesmarrje, kuote e cila zoterohet nga ortaku Ilir Shtufi dhe miratimi I blerjes se kesaj kuote nga ortaku Kujtim Shtufi.
- 2- Autorizohet Z. Enea Mitrushu me dokument identifikimi Nr. I50823030K për depozitimin e këtij vendimi në QKR.


Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike dhe shoqërohet me procesverbalin e mbledhjes.

ORTAKET


Ilir SHTUFI



Kujtim SHTUFI




Enea MITRUSHI
Administrator

PROCES VERBAL

I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE

Sot, më datë 16.10 2023, në selinë e Shoqërisë "LTD" shpk, me ortakë Z. Ilir Shtufi, Z. Kujtim Shtufi dhe Z. Luciano Koceku dhe me administrator Z. Enea Mitrushi, e regjistruar në organet tatimore dhe QKB me numër Nuis L42117004B, me seli në Rr. "Kajo Karafili", Pallati Mc Inerte, Kati i Dytë, Tiranë, në mbështetje të Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë, bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ku te pranishëm ishin:

Ortaku Kujtim Shtufi – zotërues i një kuote me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë

Ortaku Ilir Shtufi – zotërues i një kuote me 10 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë

Ka marrë dëgjimi dhe nuk është paraqitur ortakët:

Luciano Koceku – zotërues i një kuote me 40 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë

Asambleja verifikon dokumentacionin përkatës dhe konstaton se të gjithë ortakët janë njoftuar e kanë marrë dëgjimi rregullisht, konstaton se Asambleja e Përgjithshme është thirrur rregullisht dhe 2 ortakët janë prezent ortakët i tretë ka njoftuar që nuk ka pretendime dhe nuk do paraqitet. Në këto kushte vendimet e marra nga kjo Asamble do të konsiderohen të vlefshme e të ligjshme.

Enea Mitrushi, zgjidhet mbajtës i procesverbalit

Me qëllim që të shqyrtohet rendi I dëgjimit si më poshtë:

1. Miratimi i shitjes së Kuotes me 10% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë "LTD" shpk, kuote e cila zotërohet nga ortakët Ilir Shtufi dhe miratimi i blerjes së kësaj kuote nga ortakët Kujtim Shtufi.
2. Apropovimin për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit të këtij vendimi
3. Të ndryshme.

PIKA E PARË E RENDIT TË DËGJIMIT: 1.- Miratimi i shitjes së Kuotes me 10% pjesëmarrje, kuote e cila zotërohet nga ortakët Ilir Shtufi dhe miratimi i blerjes së kësaj kuote nga ortakët Kujtim Shtufi.

Merr fjalën Z. Enea Mitrushi i cili së pari konfirmon njoftimet përkatëse dhe ben më dëgjimi se ortakët Luciano Koceku ka marrë dëgjimi për mbledhjen dhe për rendin e dëgjimit dhe nuk është paraqitur (ka njoftuar që është dakort me rendin dhe se nuk mund të paraqitet). Njëherazi është komunikuar me përfaqësuesin e tij me prokuror Znj. Marsida Cara nëse ka ndonjë pretendim për shitjen dhe është shprehur (verbalisht) që nuk ka. Në këto kushte është e drejtë që të vazhdohet kjo mbledhje.

Ortakët Ilir Shtufi ka kërkuar thirrjen dhe mbajtjen e kësaj mbledhje përkrahur për të miratuar transaksionin për shitjen e kuotes që ai zotëron. Z. Kujtim Shtufi në vijim të njoftimit për ushtrimin e të drejtës së parablërjes, ka shprehur interes dhe dëshiron të blejë kuotën që z. Ilir Shtufi gëzon kuote kjo me 10% pjesëmarrje në shoqëri. Aktualisht Ortakët Kujtim Shtufi zotëron një kuote me 50% pjesëmarrje.

Ortakët Ilir Shtufi shprehur se është dakort dhe dëshiron të shesë ortakët Kujtim Shtufi i cili njëherazi dëshiron të blejë kuotën me 10% pjesëmarrje që z. Ilir Shtufi zotëron. Në përfundim të kësaj transaksioni ortakët Kujtim Shtufi do të zotërojnë një kuote me 60% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë ndërsa ortakët Ilir Shtufi do të largohet nga shoqëria.

Asambleja mori vendimin e meposhtem:

VENDIM 1
ME UNANIMITET

Miratohet shitja e Kuotes me 10% pjesemarrje, kuote e cila zoterohet nga ortaku Ilir Shtufi dhe miratimi i blerjes se kesaj kuote nga ortaku Kujtim Shtufi.

PIKA E DYTE E RENDIT TE DITES: 2.- Arovimin per regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit te ketij vendimi.

Bazuar ne aktivitetin e shoqerise administratori Z. Enea Mitrushi eshte personi pergjegjes per te rregjistruar kete akt sipas parashikimeve dhe per te ndjekur cdo procedure te domosdoshme prane organeve dhe institucioneve shteterore dhe private.

Asambleja mori vendimin e meposhtem:

VENDIM 2
ME UNANIMITET

Miratohet autorizimi i Z. Enea Mitrushi me dokument identifikimi Nr.I50823030K per depozitimin e ketij vendimi dhe cdo akti tjetër deri ne realizimin dhe pasqyrimin perfundimtar në QKB te transaksionit te shitjes..

PIKA E TRETE E RENDIT TE DITES : 3.- Te ndryshme.


Per kete pike asambleja nuk mori vendim pasi ishin diskutime normale mbi aktivitetin e shoqerise largimin e ortakeve dhe aktet qe duhet te hartohen per largimin e tyre si dhe mundesite per vijimesine e biznesit.

Mbledhja e Asamblese te Ortakeve, e dites se Hënë, date 16.10.2023, konsiderohet e mbyllur.


Ky dokument I lexohet paleve, te cilet konstatojne se shpreh vullnetin e tyre te lire dhe se pasqyron gjithcka qe eshte shprehur dhe dakorduar ne mbledhje, duke nenshkruar kete Proces Verbal ne 2 fletet e tij, ne 3 kopje.

Ky proces verbal shoqerohet nga dokumenti Vendim i Asamblese se Pergjithshme te ortakeve.


ORTAKET PJESEMARRES NE MBLEDHJE


Ilir SHTUFI



Kujtim SHTUFI


Prezent administratori
Enea MITRUSHI


Enea Mitrushi

Tirane me 09/10/2023

**Njoftim për mbledhjen e Asamblesë të Ortakëve
të Shoqërisë "LTD" SHPK**

Njoftojmë se në datën 16/10/2023, në orën 10:00, në zyrat e shoqërisë, do të mbahet Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "LTD" SHPK, për të diskutuar dhe vendosur lidhur me rendin e dites të detajuar si vijon:

1. Miratimi i shitjes së një Kuote me 10% pjesëmarrje, kuote e cila zotërohet nga ortakët Ilir Shtufi dhe miratimi i blerjes së kësaj kuote nga ortakët Kujtim Shtufi.
2. Aprovimin për regjistrimin në Qendren Kombëtare të Biznesit të këtij vendimi
3. Të ndryshme.

Ne vijim të dy njoftimeve të mëparshme, mëqenese është lajmërimi i fundit kërkojmë prezencën tuaj, duke firmosur këtë njoftim për marrjen në dijeni.

**Shoqëria "LTD" SHPK
Administrator**

Enea MITRUSHI

Enea Mitushi

Ortak
Kujtim Shtufi

KUJTIM SHTUFI




Ortak
Luciano Koceku

*P/ Marsida
Cora*

Ortake
Ilir Shtufi

Ilir Shtufi

*PROKURE DATË 29.06.2022
REP. 973 Kd. 690*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERNITA A. HAXHIU
ADRESA KAJO KARAFILI,
PALL."MC INERIE"
TEL:

PROKURË E PËRGJITHSHME

Nr. repertori: 973

Nr. koleksioni: 690

Tirane më 24/06/2022

Taksa e Pullës
U Pagua



PROKURË PËRGJITHSHME

Sot ne Tirane, me date 24/06/2022, ne Zyren e Noterise Tirane, para meje notere **Ernita Haxhiu**, me seline Tirane, Rr. "Kajo Karafili" u paraqiten palet si me poshte:

I PËRFAQËSUARI :

Z.Luciano Koçeku, atesia Mersim, lindur ne Bulqize, Diber, me date 25.01.1982 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes i kartes se identitetit me Nr.**I20125096T**:

Pala e mësipërme, me vullnet të tij të lirë dhe të plotë kërkoi përpilimin e kësaj Prokure te Pergjithshme si mëposhtë:

"Une, **Z.Luciano Koçeku**, emëroj si përfaqësuese të Përgjithshme, **Znj.Marsida Cara**, e bija Xhevat, lindur me 01.04.1984 ne Mamurras dhe banues ne Tirane, identifikuar me karte identiteti Nr.**I45301092A**, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar. të cilit i jap të drejtë dhe kompetence të plotë për të kryer, veprimet e mëposhtme:

Përfaqësuesi ka të drejtë :

Për të me përfaqësuar mua, në të gjitha çështjet për ndjekjen dhe realizimin e çdo procedure ligjore dhe administrative që ka të bëjë me pronat e luajtshme dhe paluajtshme sit e ardhshme dhe te tashme të kudo ndodhura në emrin tim , në cilësinë e pronarit apo të bashkëpronarit të përfituara në të gjithë mënyrat e fitimit të pronësisë apo me trashëgimi.

- **Përfaqësueses time te pergjithshme**, i jap të drejtë dhe kompetencë që të paraqitet pranë cdo zyre noteriale, të lidhë, të nënshkruajë apo të revokojë çdo lloj veprimi juridik dhe akti noterial, kontrate shitje-blerje, ne cilesine e blesesit apo te shitesit, dhurimi si dhuruese apo si pranues, deklarate heqje dorë , kontrate sipërmarrje , amendim kontrate, revokim kontrate sipërmarrje, kontrate kalim te drejtash, , Kontrate Huaje, Deklarate Noteriale, kontrate kalim te drejtash, dhe çdo kontrate tjetër te parashikuar nga Kodi Civil, me qëllim tjetërsimin dhe administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe te drejtat reale që rrjedhin prej tyre, me qëllim shitjen, blerjen, dhurimin, pjestimin, dhënien në huapërdorje, shkëmbimin, dhënien me qira, dhe çdo veprimi tjetër juridik pa kufizim, me objekt çdo pasuri të tashme dhe mbi pasuri të ardhshme te luajtshme apo te paluajtshme .
- **Përfaqësueses time te pergjithshme Znj.Marsida Cara**, i jap te drejta te paraqitet pranë ASHK me te drejta dhe kompetenca te plota ligjore te kryej te gjitha veprimet, te aplikoje, te marre informacion, te tërheqë dhe te nënshkruaj çdo dokument qe mund ti kërkohet nga ky institucion ne lidhje me pasuritë luajtshme dhe paluajtshme të kudo ndodhura.
- **Përfaqësueses time të përgjithshme, Znj.Marsida Cara**, i jap të drejtë dhe kompetencë që të paraqitet pranë cdo lloj zyre të institucioneve të administratës publike, per zhdoganim, kolaudime, sigurim mjeti, ndërrim targe, kryerjen e kontrollit teknik, etj, pranë cdo lloj zyre private për përkthime, noterime apo pranë çdo lloj institucioni tjetër që ka të bëjë më kryerjen e çdo lloj veprimi ligjor, administrativ dhe financiar si bankë etj, në



A202203066007546127

lidhje me kryerjen e cdo procedure ligjore ,tatimore etj që ka të bëjë me administrimin dhe tjetërsimin e mjeteve te kudo ndodhura ne emrin tim dhe të drejtat reale që rrjedhin prej tyre për llogarinë time.

- Përfaqësuesja ime, ka te drejte te paguaje te gjitha detyrimet qe lidhen me qarkullimin e mjeteve te kudondodhura ne emrin tim. Gjithashtu ka te drejta te kryeje te gjitha veprimet qe lidhen me taksat e qarkullimit rrugor, te realizoje pagesa pranë bankave, te nënshkruaje kontrata siguracioni, apo dhe te paguajë gjrobat e vena, pagesat fiskale, po ashtu përfaqësuesi im ka te drejte qe ta tërheqe mjetin pranë autoriteteve policore, gjyqësore, administrative, ne rast bllokimi, apo aksidenti. Te kryeje te gjitha veprimet ne emer dhe per llogarine time pranë Drejtorise se Përgjithshme të Shërbimeve te Transportit Rrugor Tiranë, DPSHTRR për ndjekjen dhe realizimin e çdo procedure ligjore dhe administrative e mjeteve te kudo ndodhura ne emrin tone.

- Ajo ka të drejtë që të paraqitet pranë cdo lloj banke te nivelit te dyte si psh (Raiffeisen Bank, Credins Bank, Alpha Bank, BKT, Union Bank, Tirana Bank, FI Bank, Intesa San Paolo Bank,etj), te hape llogari bankare ne emrin tim, te mbylle llogari bankare ne emrin tim, të tërheqe para fizike nga llogaria bankare, te kryejë transferta brenda dhe jashte vendit nga llogarite bankare, te beje derdhje, te depozitoje, të marrë kredi, duke vënë kolateral pasuritë e regjistruara ne emrin tim dhe te kryeje cdo lloj procedure tjetër bankare ne cdo lloj monedhe, me çdo lloj banke apo çdo lloj dege Banke në Republikën e Shqipërisë për kryerje veprimesh pa kufizim. Per kete perfaqesuesit i jap te drejte qe ne emrin dhe per llogarine time te nenshkruaje, plotesoje, depozitoje cdo dokument te nevojshem dhe te ligjshem, duke pasur te drejte te nenshkruaje lirisht cdo lloj dokumenti, formulari apo kerkese qe do ti kerkohet per kryerjen e ketyre veprimeve bankare nga cdo institucion financiar/bankar.

Ne rast se do te jete e nevojshme, perfaqesuesit tim i jap te drejte qe te hape numer te ri "Llogarie Rrjedhese apo cdo lloj depozite" pranë cdo banke te nivelit te dyte qe operon ne Republikën e Shqipërisë.

- Për këto pasuri, përfaqësueses time, i jap të drejtë dhe kompetencë të plotë që të paraqitet pranë çdo lloj zyre të institucioneve të administratës publike, si Njësi e Qeverisjes Vendore ku ndodhen pronat, DAMT-Këshilli I Qarku , Agjensi Kthimi dhe Kompensimi të Pronave,Gjendje Civile, Qendra Kombëtare e Biznesit, OSHEE, UKT, etj, pranë cdo organi tatimor, pranë cdo lloj zyre private apo pranë çdo lloj institucioni tjetër që ka të bëjë me kryerjen e çdo lloj veprimi ligjor, administrativ, dhe financiar në lidhje me kryerjen e cdo procedure ligjore ,tatimore etj, për administrimin dhe tjetërsimin e pasurive duke pasur të drejtë të kërkojë, të dorëzojë dhe të tërheqë çdo dokument.
- Përfaqësuesja ka te drejte qe te me përfaqësoje ne cilëndo Gjykate për konflikte qe mund te rezultojnë ne lidhje me pasuritë me përshkrimin e mësipërm. Ka te drejte te përpiloje kërkesa per gjykate, padi, kundrapadi me te drejte nënshkrimi, te marre pjese ne te gjitha seancat gjyqësore ne cilësinë e paditësit, e paditurit, apo personit te interesuar, te paraqesë prova shkresore, si dhe te kryej çdo veprim tjetër te nevojshëm deri ne përfundimin e gjykimit. Ka te drejte te beje akimime te veçanta dhe te ndërmjetme, te rivendose ankimet me afat, te me përfaqësoje ne Gjykatën e Apelit dhe ne Gjykatën e Larte me kërkesë rishqyrtimi. Ka te drejte qe te ekzekutoje çfarëdo lloj vendimi administrativ apo gjyqësor me anën e Zyrës se Përmbarimit.
- Përfaqësuesja ka te drejte qe për probleme te veçanta te emëroje avokat për ndjekje te çështjeve civile dhe zgjidhje te çështjeve administrative qe do te kenë lidhje me pasuritë e luajtshme apo te paluajtshme.
- Perfaqesuesja ka te drejte te paraqitet perpara cdo autoriteti dhe zyre per te kerkuar cfaredo dokumenti qe ai e gjykon te domosdoshem, te drejtat personale te nenshkruarit, te drejten per te paraqitur kerkesa dhe dokumenta te ndryshme para cdo autoriteti dhe zyre



A2022030660078546127

qe lidhen me mbrojtjen e interesave te ligjshme te perfaqesuarit, te drejten per te terhequr prane cdo zyre cdo dokument qe i kerkohet.

- Perfaqesuesja , ka te drejte te kryejë cdo veprim juridik ne emrin dhe per llogarine tone, pa asnjë lloj kufizimi dhe pa patur mundësi të tretët për të gjetur mangësi tagrash në këtë përfaqësim.

Të gjitha veprimet e kryera prej tij për qëllimet e përmëndura si më lart i konsiderojme të drejta dhe të mirëqëna si të ishin të kryera prej nesh personalisht .

Kjo prokurë është e vlefshme deri kur të shfuqizohet nga ana ime.

Baza ligjore : Neni 70 e vijues i Kodit Civil .

Sa më sipër, prokura u redaktua, u lexua me zë, u kuptua nga porositësi dhe me vullnetin e lirë e të plotë të saj, nënshkruhet në prani të Noteres dhe unë Noterja pasi u binda për vullnetin e deklarimit lejoj nënshkrimin dhe e legalizoj atë sipas ligjit.

I PERFAQESUARI:

Z. Luciano Koçeku

Luciano Koçeku

NOTERE

ERNITA HAXHIU

Ernita Haxhiu